



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 598/6 prot.

Tiranë, më 03.05.2024

REKOMANDIM

Nr. 03, datë 03.05.2024

**PËR KONTROLLUESIN “SHKOLLA JOPUBLIKE ARSAKEIO GREEK-
ALBANIAN COLLEGE”**

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar (në vijim, “*Ligji*”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” (në vijim, “*Kodi i Procedurave Administrative*”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “*Shkolla Jopublike Arsakeio Greek-Albanian College*” (në vijim, “*Kontrolluesi*),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 52, datë 29.02.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Komisioneri*”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është një shoqëri e regjistruar me numër identifikimi J82217003V në Tiranë, e cila ushtron aktivitetin e saj në fushën e arsimit për nivelin parashkollor,

nivelin nëntëvjeçar dhe arsimit i mesëm, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë “nxënës”, “prindër”, “staf akademik”, “punonjës”, “vizitorë”, etj.

2. Kontrolluesi administron dokumentacionin e grumbulluar për stafin akademik dhe nxënës në arkivën fizike, si dhe në Zyrën e Drejtorit. Konstatohet se, në Zyrën e Drejtorit, ruhen dosje që përmbajnë dokumente të punonjësve të larguar si, Dëshmi Penaliteti, kopje ID, CV, Kontratë pune, etj.

Nga analizimi i Rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, rezulton se Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale, për dokumentacionin që administron në funksion të veprimtarisë që ushtron, në kundërshtim me germën “d” të pikës 1, të nenin 5 të Ligjit, si dhe me Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat” i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me të dhënat personale të grumbulluara, Kontrolluesi duhet të parashikojë ruajtjen e të dhënave personale në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e grumbullimit. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e grumbullimit të informacionit.

3. Kontrolluesi disponon një sistem të video-survejjimit (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të institucionit, për qëllim të sigurisë së personelit, nxënësve dhe pronës.

Konstatohet se, nuk janë vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimin e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Gjithashtu, lidhur me këtë proces përpunues, Kontrolluesi nuk ka miratuar rregulla/politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video-survejjimit CCTV, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit, si dhe Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

Sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video regjistrimi është në veprim, duke vendosur njoftimin e shkruar në hapësirën e monitoruar.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të parashikoj rregulla/politika dhe të marrë masa teknike-organizative, në mënyrë që të mbrohen sistemet e regjistrimit, mënyrat e transferimit dhe mjetet transmetuese në të cilin gjenden regjistrimet duke i mbrojtur nga aksesit i paautorizuar apo aksidental, ndryshimi, shkatërrimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar.

4. Kontrolluesi ka lidhur “*Kontratë Regjistrimi*” me prindin, në lidhje me pagesat mujore të shkollës. Në kontratë rezulton se prindi duhet të plotësojë disa fusha, ndër të tjera “*emri*”, “*profesioni*”, “*ditëlindja*”, “*adresa*”, “*ID*”, “*nr. cel*”, “*email*”, etj., por konstatohet se subjektet e të dhënave nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit.

Gjithashtu, Kontrolluesi aplikon një “*Deklaratë personale të prindit*” nëse prindi është dakort ose jo për publikimin e fotove të fëmijëve në aktivitetet e Kontrolluesit.

Lidhur me dy format e dokumenteve të mësipërme, rezulton se informimi i realizuar nga Kontrolluesi përkundrejt subjekteve të të dhënave nuk është shterues në lidhje me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

5. Kontrolluesi për montimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të video-survejjimit (CCTV) që disponon, ka lidhur “*Kontratë Furnizimi*” me subjektin tregtarë “*LV4tech*”. Nga verifikimi i kësaj kontrate, rezulton se, në përmbajtje të saj nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*” i ndryshuar (në vijim, *Udhëzimi nr. 19*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e

tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të jetë në përputhje me nenin 20 të Ligjit dhe me Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit.

6. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se Kontrolluesi ka njoftuar mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Mirëpo, gjatë hetimit administrativ të ushtruar, është konstatuar se “*Njoftimi*” ka mangësi në deklaram, sa i përket rubrikave të formularit si vijon:

- Deklarimin në rubrikën 3.1, të formularit të njoftimit “*Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”
- Deklarimi në rubrikën 4.1, të formularit të njoftimit “*Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*”;
- Deklarimi në rubrikën 6.1, të formularit të njoftimit “*Qëllimi i përpunimit*”;
- Deklarimin në rubrikën 7.1, të formularit të njoftimit “*Marrësi i të dhënave personale*” ;
- Deklarimin në rubrikën 9.1, të formularit të njoftimit “*Mjetet e përpunimit të të dhënave personale*”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

7. Kontrolluesi ka hartuar Rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” por nga verifikimi rezulton se kjo Rregullore nuk është e plotë pasi në të nuk parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një Rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave

8. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin shqiptar në

fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, natyrës së veprimtarisë që ushtron, si dhe për shkak të kategorive të të dhënave personale që përpunon, kërkohen masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale.

Sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky është një detyrim i vazhdueshëm i Kontrolluesit që personeli i subjektit përpunues të të dhënave personale të trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare nëpërmjet shkresës nr. 598/3 prot., datë 15.04.2024.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesit është paraqitur në seancë dëgjimore datë 25.04.2024, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar, duke paraqitur dokumentet si vijon:

1. Formularin “*Deklaratë Ndryshimi*”.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit të Formularit vlerëson se në rubrikën 3.1 dhe në rubrikën 7.1, duhen bërë përditësimet sipas veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron. Realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore.

2. Rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit të Rregullores vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (psh., masat e sigurisë lidhur me të dhënat sensitive, nëse kryhet transferim i të dhënave masat e marra lidhur me këtë

përpunim dhe kategoritë e të dhënave që transferohen, etj.), afatet e mbajtjes së të dhënave, etj. Kjo Rregullore duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale, në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

3. Dokumentet “Deklaratë pëlqimi për punonjësit dhe prind/kujdestar ligjor”, si dhe dokumenti “Kërkesë Regjistrimi” që plotësohet nga prindi për regjistrimin e fëmijës në shkollë, ku është parashikuar edhe paragrafi *“Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 8517 datë 22.07.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”*”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave nuk është i plotë dhe shterues. Kur mbledh të dhëna personale, Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhëna personale, mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij, etj.

4. Kontrolluesi ka vendosur tabelën e informimit për prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV).

Konstatohet se, tabela nuk përmban elementët formal të informimit. Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Kontrolluesi detyrohet të vendosë në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejjimit të miratuar nga Komisioneri nëpërmjet Udhëzimit nr. 3.

5. Lidhur me Kontratën me subjektin tregtarë “LV4tech”, Kontrolluesi deklaroi se subjekti “LV4tech” kryen vetëm mirëmbajtje teknike dhe jo filmike të kamerave.

Referuar Kontratës me subjektin tregtarë “LV4tech”, Kontrolluesi, ndër të tjera, i ka deleguar procesin e mirëmbajtjes së sistemit të video-survejjimit CCTV. Zyra e Komisionerit vlerëson se, për aq kohë sa punonjës të “LV4tech” kryejnë mirëmbajtjen e CCTV dhe të arkivimit të pamjeve filmike, të cilat përmbajnë imazhe, video të subjekteve të të dhënave, atëherë, në këtë Kontratë duhet të parashikohen detyrimet e Kontrolluesit dhe Përpunuesit, sipas parashikimeve në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 18, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të marrë masa që të rishikojë çdo proces përpunimi të të dhënave personale, për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
2. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar kontratën me përpunuesin duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19;
4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të “Njoftojë” Zyrën e Komisionerit, për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, etj.;
6. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale;
7. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 1, 2 dhe 4 më sipër;
 - (ii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 3 dhe 5 më sipër;
 - (iii) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 6 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

8. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
9. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast

shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 03.05.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi